



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale 03/L-040, nenit 4 deri në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2016 nga MAPL, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës si dhe nenit 3,4,5,6,7 dhe 8 të Rregullores komunale për Komitete Konsultative /2012, si dhe Vendimit të Komunës së Klinës, nr.01Nr.-06-631/2018 miratuar me 06.02.2018, Kuvendi i Komunës së Klinës vendosi, të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për

ANTARËSIMIN NË KOMITETET KONSULTATIVE TË KOMUNËS

1. Komiteti për Çështje Emergjente dhe
2. Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Secili Komitet përbëhet nga 5 anëtarë.

I. KUSHTET DHE KRITERET E ANËTARËSIMIT:

Anëtarët e Komiteteve konsultative duhet t'i përmbushin këto kriterë:

1. Të jenë banorë të Komunës së Klinës,
2. Të kenë përgatitjen superiore-profesionale të fushës përkatëse mundësisht të fakultetit,
3. Të jetë njohës i punës me kompjuter (dëshmia e kurseve përkatëse),
4. Të drejtë aplikacioni kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që i përmbushin kushtet.

PËRSHKRIMI I PUNËVE :

- Anëtarët e Komiteteve Konsultative duhet të kenë aftësi për paraqitjen e ideve, mendimeve dhe hulumtimeve si dhe dhënien e propozimeve të ndryshme për rregullativa komunale dhe iniciativave të ndërmarra nga organet komunale,
- Gjithashtu, këto komitete paraqesin mendimet e qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës dhe të japin propozime për probleme të identifikuara,
- Këto komitete duhet të hartojnë planin e punës dhe kalendarin për takime për secilin vit, në të cilin duhet të përfshijnë takimet e rregullta me kuvendin e komunës si dhe takime të rregullta me Kryetarin e Komunës
- Komitetet Konsultative obligohen të dorëzojnë raport vjetor për punën e vet Kuvendit të Komunës.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Aplikacioni merret në Shërbimin për punët Kuvendit duke ia bashkangjitur dokumentet tjera si në vijim:

- Diplomën e Fakultetit apo të shkollës së mesme (të noterizuar),
- Ekstraktin e lindjes,
- Letërnjoftimi i fotokopjuar,
- Dëshmi për kurset e kompjuterit.

II.

Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është katër (4) vjeçar nga themelimi i komitetit dhe nuk mund të shërbejnë ma shumë së dy mandate të njëpasnjëshme.

Komitetet mbajnë së paku gjashtë takime (6) në vit dhe kompensohen nga buxheti i komunës jo më shumë së për gjashtë (6) takime në vit.

Kompensimi duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Në këto komitete duhet të merret në konsideratë barazia gjinore.

III.

Afati i konkursit dhe procedura e konkurrimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Kuvendit nr.3, në objektin e Komunës së Klinës, rruga "Abedin Rexha" Klinë.

IV.

Paneli intervistues i themeluar nga Kuvendi i Komunës i propozon listën e kandidateve për dy komitetet, Kuvendit të Komunës për miratim.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 111-1843/ 2018
Klinë, më 15.03/ 2018

